



VENDIM

Nr. 149 Datë 24.12.2013

MBI

SHTYRJEN E AFATIT TË VENDIMIT NR. 54 DATË 03.05.2013 TË BORDIT TË KOMISIONERËVE TË ERE-S “MBI SHTYRJEN E AFATIT TË VENDIMIT NR. 161, DATË 07.12.2012, TË BORDIT TË KOMISIONERËVE

Në mbështetje të neneve 8, pika “b” dhe “ç”; 9 dhe 26 të Ligjit Nr. 9072, datë 22.05.2003, “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, të ndryshuar, neneve 18; 20 dhe 21 të Rregullave të Praktikës dhe Proçedurave të ERE-s, miratuar me Vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s nr. 21, datë 18.03.2009, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (E.R.E), në mbledhjen e tij të datës 24.12.2013, pasi shqyrtoi relacionin e Drejtorive Teknike,

Konstatoi se:

- Kompania CEZ Shpërndarje referuar vendimin nr. 5 Janar 2013 është në administrim të përkohshëm
- CEZ Shpërndarje sh.a dhe KESH sh.a nuk kanë mbyllur rakordimet për blerjet dhe shitjet e energjisë elektrike midis tyre për periudhën 2011 -2012 si pamundësi kjo për shkak të statusit juridik të CEZ Shpërndarje sh.a gjatë këtij viti.
- Vendimin nr. 87 datë 29.06.2012, i Bordit të Komisionerëve të ERE ka përcaktuar tarifën e furnizuesit publik me shumicë për periudhën 2012-2014 në vlerën 2.2 lekë.
- Përcaktimi i të ardhurave të tepërta për efekt të axhustimit të tarifës së transmetimit të cilat rezultojnë nga rritja e sasisë së levruar të energjisë elektrike

për mbulimin e humbjeve në sistemin e shpërndarjes është i kushtëzuar me tarifën e shpërndarjes.

- Përcaktimi i tarifës së shpërndarjes është i lidhur me vlerësimin më parë të komponentëve të saj të tillë si niveli i humbjeve dhe sasia e lëvruar në rrjetin e shpërndarjes, investimet e kryera.

Per gjithë sa me sipër cituar Bordi i Komisionereve të ERE-s,

Vendosi:

1. Të lërë në fuqi deri në datën 31 Dhjetor 2014, tarifat e miratuara përkatësisht me vendimet si më poshtë :
 - Vendimin nr. 144, datë 07.12.2011 “Për përcaktimin e tarifës së prodhimit të energjisë elektrike nga KESH sh.a për Periudhën e Tretë Rregullatore”.
 - Vendimin nr. 87, datë 29.06.2012 “Për rishikimin e tarifës për Furnizuesin Publik me Shumicë për Periudhën e Tretë Rregullatore për akomodimin e efekteve financiare të vendimit nr. 80 datë 15.06.2012 të Bordit të Komisionerëve të ERE-s”.
 - Vendimin nr. 151, datë 7.12.2011, “Për përcaktimin e çmimit të shitjes të energjisë elektrike të prodhuar nga TEC Vlore sh.a tek FPSH, për Periudhën e Tretë Rregullatore”.
 - Vendimin nr. 153, datë 07.12.2011 “Për përcaktimin e tarifës së prodhimit të energjisë elektrike nga HEC Lanabregas sh.a për Periudhën e Tretë Rregullatore”.
 - Vendimin nr. 146, datë 07.12.2011 të Bordit të Komisionerëve “Për miratimin e tarifës së transmetimit të energjisë elektrike nga OST sh.a. për Periudhën e Tretë Rregullatore”.
 - Vendimin nr.147, datë 07.12.2011 “Për përcaktimin e tarifës së shpërndarjes së energjisë elektrike për periudhën e tretë rregullatore 2012-2014 dhe Nr.148 datë 07.12.2011 “Për përcaktimin e çmimeve të shitjes me pakicë të energjisë elektrike për konsumatorët tariforë për periudhën e tretë rregullatore”.

- Vendimi nr. 149, datë 07.12.2011 “Për përcaktimin e çmimit unik të shitjes së energjisë elektrike për të licencuarit për prodhimin e energjisë elektrike nga hidrocentralet e rinj me fuqi të instaluar deri në 15 MË për vitin 2012”
 - Vendimi nr. 150, datë 07.12.2011 “Për përcaktimin e çmimit unik të shitjes së energjisë elektrike për të licencuarit për prodhimin e energjisë elektrike nga hidrocentralet ekzistues me fuqi të instaluar deri në 10 MË për vitin 2012”.
2. Përditësimin dhe kompensimin e të gjitha efekteve financiare brenda të njëjtës periudhë rregullatore 2012-2014, apo në periudhën rregullatore pasardhëse, periudhë e cila do të shërbejë për qartësimin e gjendjes juridike të kompanisë së shpërndarjes, duke i krijuar kështu mundësinë rregullatorit për qartësimin, verifikimin dhe përcaktimin se me të drejtë të treguesve të të ardhurave të kërkuara për aktivitetet e gjenerimit publik, furnizimit me shumicë, transmetimit, shpërndarjes së energjisë elektrike dhe furnizimit me pakicë te konsumatorët tariforë.
 3. Përditësimin dhe kompensimin e të gjithë efekteve financiare brenda të njëjtës periudhë rregullatore 2012 – 2014, apo për periudhën rregullatore pasardhëse, të çmimit unik të shitjes së energjisë elektrike për të licencuarit për prodhimin e energjisë elektrike nga hidrocentralet dhe ato ekzistues me fuqi të instaluar deri në 15 MW.
 4. Drejtoria Juridike dhe Mbrojtjes së Konsumatorit të njoftojë kompanitë e rregulluara për Vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.
Ky vendim botohet ne Fletoren Zyrtare.